

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për krime të rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj kryetar, Fillim Skoro,Gjyqtar referus,Driton Muharremi anëtar, me bashkëpunëtorin profesionalë Eroll Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh.A. nga fshati ... Komuna e Novobërdë, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll, ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK-së, dukë vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të pandehurit, av.B.T. , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, PKR.nr.326/09 të dt. 09.08.2017, në seancën e Kolegjit të mbajtur me datë 07.11.2017, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Xh.A., av.B.T., dhe aktgjykimi i të Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, PKR.nr.326/09 të dt.09.08.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, PKR.362/09 të dt. 09.08.2017, i akuzuari Xh.A. është shpallur fajtor për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll, ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënimi burgim ne kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve, nëse ne afat e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër te re penale, në te cilin dënim te shqiptuar me kusht i është llogaritur edhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak 08.04.2009 deri me datën 06.05.2009. I pandehuri është obliguar qe ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa ne emër te paushallit gjyqësor shumë prej 50(pesëdhjete) Euro, pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Ndaj të akuzuarit është refuzuar akuza për veprën penale për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll, ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.2 të KPK-së, për shkak se kjo vepër penale është përfshi ne ligjin për amnisti, ndërsa nga i është konfiskuar pushka e gjuetisë e kalibrit 12MM,me 8 copë fishek, e sipas vërtetimin mbi konfiskimin e aramtimit 2000-CN-13, të datës 08.04.2009.

Për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 pika 4 të KPK-së, është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

I dëmtuari M.Z., nga fshati ... komuna Novobërd, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.M., av.B.T. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen penale të kthejë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit- DKR- në Prishtinë me shkresën e saj PPA/I.nr.443/17, të dt. 16.07.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Xh.A. av.B.T. , ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, seancën e ka mbajtur në mungesë të palëve për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme sipas ligjit për shkak se nuk bëhet fjalë për dënim me burgim.

Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, vlerësoi ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Xh.A. av.B.T., si dhe të sqarimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit, shqyrtoi dhe vlerësoi shkresat e lëndës, dhe gjeti:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Xhelala Ahmeti, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij pretendon se i akuzuari ka pranuar që ka pasur armë dhe gjuetisë me afat të skaduar, nuk e ka ditur që duhet të vazhdohet dhe ka kërkuar falje për të. I akuzuari e as mbrojtja nuk kanë folur për përdorimin- vringëllimin e armës, dhe mbrojtja nuk ka deklaruar as një fjalë rreth kësaj pasi që procesi është zhvilluar për armbajtje të armës të gjuetisë me afat të skaduar dhe jo për armbajtje dhe vringëllim të revoles. Procesverbali që është dorëzuar nuk korrespondon me realitetin e as procesverbali që është nënshkruar përputhet me aktgjykim .

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën mbrojtësit të akuzuarit Xh.A. , e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekure më lartë, e të cila kishte me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesës të mbrojtësit të akuzuarit Xh.A., , e në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, në të cilën gjykata shikon dhe sipas detyrës zyrtare vlerëson se pretendimet ankimore të akuzuarit nuk qëndrojnë. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht, dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe çështjet që përmban aktakuza, dhe aktakuza nuk përmban shkelje ligjore siç parasheh dispozita e nenit 248 par.1.1 gjer në 1.4 të KPP, dhe gjykata e shkallës së parë pranimit e fajësisë e ka bërë në pajtim të plotë me dispozitën e lartë cekur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit , nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit , se i akuzuari Xh.A., nuk ka pranuar veprën penale për revolen që e ka mbajtur pa leje, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 09.08.2017, në faqen 3 pasusi i III, rezulton se i akuzuari Xh.A. pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka pranuar fajësinë edhe për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll, ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 të KPK-së, e më të cilin pranim të fajësisë për revolen është pajtuar edhe mbrojtësi i të akuzuarit av.B.T..

Nga kjo që u tha më lartë rezulton që aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP-së.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, edhe pse sipas kësaj baze ankimore nuk ka pasur ankesë, Gjykata e Apelit, gjen se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejt ka zbatuar rregullën e përgjithshme mbi matjen e dënimit nga neni 73 të KPRK-së, duke marr parasysh gjendjen ekonomike dhe familjare të akuzuarit Xh.A., duke marrë parasysh pranimin e fajësisë pendimin e thellë të tij ,Gjykata e Apelit vlerëson së dënimi shqiptuar dënimi burgim ne kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve, nëse ne afat e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër te re penale, është në proporcion me peshën e veprës penale dhe sjelljen e të akuzuarve, pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, dënimi i shqiptuar dhe i kushtëzuar te i akuzuari do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmen mos kryej vepra penale dhe të bëhet rehabilitimi i tij si dhe të parandaloj presona të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe me dënimin e këtillë të shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë, si në nenin 41 të KPRK.

Nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konformë nenit 401 të KPP të Kosovës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.473/207. me dt 07.11.2017

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi,

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Driton Muharremi

Kryetari i Kolegjit,

Mejreme Memaj